STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 2 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE SHERBIMI I TRENIT R ZGJATET DERI NE WHITEHALL STREET

Shërbimi do të fillojë të hënën, 3 dhjetor në 6 në mëngjes

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se shërbimi i Broduei R (Broadway R) do të zgjatet deri në Whitehall Street duke filluar në 6 në mëngjes të hënën, 3 dhjetor, duke funksionuar në jug të 34th Street për herë të pare që kur Super stuhia Sendi (Sandy) la miliona gallona të ujit gërryes me kripë në disa stacione të metrosë dhe në tunelet nën lumë.

"Rifillimi i shërbimit për në stacionin e Whitehall Street do të rivendosë një lidhje jetësore me pjesën perëndimore të mesit të qytetit për banorët e Stajtën Ajlënd (Staten Islanders) dhe gjithashtu do të lehtësojë tejmbushjen përgjatë linjës së Lexington Avenue," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo).

Punëtorët e tranzitit përmbushën detyrën e stërmadhe të riparimit dhe zëvendësimit të shinave, të shinës së tretë, sistemeve të komunikimit, pajisjet e pompimit, lidhjet elektrike dhe kontrollet në mënyrë që stacioni R në Whitehall Street të lidhej përsëri me rrjetin. Kjo do të lejojë Tranzitin MTA të Qytetit të Nju Jorkut (New York City) që të zgjasë shërbimin e trenit R nga 34th Street në Whitehall Street në Manhatanin e poshtëm (lower Manhattan) duke lehtësuar barrën në linjën e Lexington Avenue.

Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota) deklaroi, "Punëtorët e tranzitit vazhdojnë të punojnë pa pushim për të rikthyer në funksionim tunelin Montag (Montague), i cili do të përfundojë lidhjen e linjës R nga Manhatani i poshtëm (lower Manhattan) deri në qendër të Bruklinit (Downtown Brooklyn)."

Udhëtarët duhet të dinë se vetëm një shkallë lëvizëse në këtë stacion të thellë është në funksionim. Shkalla lëvizëse në skajin verior të stacionit (hyrja nga Stone Street) më parë ishte hequr nga shërbimi për zëvendësim dhe mbetet jashtë funksionimit. Dy shkallët lëvizëse në skajin jugor pësuan dëm të rëndë pas stuhisë, por njëra është rikthyer në funksionim. Udhëtarëve që kanë vështirësi në ngjitjen e shkallëve u këshillohet të mendojnë që të përdorin përkundrazi stacionin R në Rector Street.

Mbetet shumë punë në mënyrë që të rikthehet tuneli Montag (Montague) që transporton trenat R ndërmjet Manhatanit të poshtëm (lower Manhattan) dhe qendra e Bruklinit (downtown Brooklyn). Punëtorët janë duke riparuar dhe zëvendësuar qindra rele, çelësa të shinave, motorë të ndalesave dhe lidhje elektrike. Shërbimi për në Bruklin (Brooklyn) pritet deri në fund të dhjetorit.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418